

GJYKATËS SUPREME TË KOSOVËS

nëpërmjet

GJYKATËS THEMELORE NË PRISHTINË

Numrat e lëndëve:

1. AA.nr.355/20, Gjykata e Apelit;
2. A.nr.3090/19, Gjykata Themelore Prishtinë;

PALËT:

Paditës: Sami Kurteshi, me adresë, rr. "Xhavit Ahmeti, nr.9/A, Prishtinë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson, Getoar Mjeku, me adresë, rr. "Enver Maloku", nr.100.

E Paditur: "Zyra e Rregullatorit për Energji Elektrike", me seli në Prishtinë.

Palët e Interesit:

- I. "Alsi&CO – Kosovë L.L.C" SH.P.K, me numër unik identifikues 810875552,
- II. "VBS" SH.P.K, me numër biznesi 70325365;
- III. "VITA ENERGY"SH.P.K, me numër biznesi 71218376;
- IV. "ABRAZEN LLC", me numër biznesi 70100453;
- V. "ENERGY DEVELOPMENT GROUP KOSOVA" SH.P.K, me numër biznesi 717276643;
- VI. "SOLAR GATE LLC", me numër biznesi 71280888;
- VII. "Building Concstruction"

Të përfaqësuara, sipas autorizimit nga avokatët: **Faton Qirezi**, me seli në Prishtinë, rr. "Muharrem Fejza", Hy C15/15, nr.23 dhe **Alban Makolli**, me seli në Prishtinë, rr. "Muharrem Fejza", Hy C15/17, nr.5

VENDIMI I FORMËS SË PRERË I ATAKUAR:

Kundër Aktvendimit AA.nr.355/2020, i marrë nga Gjykata e Apelit e Kosovës, më datë 17.06.2020, me të cilin është Vërtetuar, Aktvendimi A.nr.3090/19, i marrë nga Gjykata Themelore në Prishtinë, më datë 06.04.2020, me të cilin është shtyer ekzekutimi i Vendimit V_1204/2019, i datës 27 nëntor 2019, i marrë nga Zyra e Rregullatorit për Energji Elektrike, palët e interesit juridik, përmes përfaqësuesve të tyre, në bazë të nenit 24 lidhur me nenin 50, të Ligjit nr. 03/L-202 për Konfliktin Administrativ (tutje LKA), Gjykatës Supreme të Kosovës, i paraqesin këtë:

KËRKESË PËR RISHQYRTIM TË JASHTËZAKONSHËM TË VENDIMIT

Përmes të cilit kundërshtohen në tërësi Vendimet gjyqësore, të cekura më lartë,

Për shkak të:

- Shkeljes së nenit 22 të Ligjit për Konfliktin Administrativ dhe nenit 175 lidhur me nenin 160 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (tutje LPK-së);

I.HISTORIKU PROCEDURAL:

1. Më datë, 24.12.2019, paditësi Sami Kurteshi, kishte inicuar Konfliktin Administrativ, kundër të paditurës ZRRE, duke kërkuar që të Anullohet Vendimi V_1204_2019, i marë nga e njëjta më datë, 27.11.2019.

Njëkohësisht kishte kërkuar që të shtyhet ekzekutimi i Vendimit të atakuar nga i njëjti, me pretendimin se ekzekutimi i tij, paditësit i sjellë dëm të pariparueshëm.

2. Më datë, 27.12.2019, Gjykata Themelore në Prishtinë, bjen aktvendimin **A.nr.3090/19**, me të cilin e Aprovon kërkesën e paditësit, dhe e shtyen ekzekutimin e aktit të kontestuar nga paditësi me konflikt administrativ.

Aktvendimi i Gjykatës, nuk përmbante asnjë fakt, se në çka konsiston dëmi që do ti shkaktohet paditësit nga ekzekutimi i aktit të kontestuar, me çfarë prove provohet dëmi i pretenduar, dhe pse i njëjti paraqet dëm të pariparueshëm. Njëkohësisht gjykata, nuk ka paraqitur asnjë fakt se pse shtyerja e aktit të kontestuar nuk është në kundërshtim me Interesin Publik dhe nuk i shkaktton ndonjë dëm palëve të treta. Këtij vendimi gjyqësor i mungonte në tërësi arsyetimi mbi arsyet vendimtare për shtyerjen e ekzekutimit.

3. Kundër Aktvendimit të cekur në paragrafin 2, e paditura ZRRE dhe palët e interesit kishin parashtruar ankesat e tyre, duke e informuar gjykatën për dëmin që u shkaktohet të njëjtave nga shtyerja e ekzekutimit të aktit të kontestuar, e as mos plotësimin e kushteve tjera për shtyerje të ekzekutimit të aktit të kontestuar të cilat kërkohen me nenin 22 par.2 të LKA-së, si dhe mos paraqitjen e asnjë arsye dhe prove në vendimin e gjykatës lidhur me plotësimin e kushteve nga neni 22 par. 6 lidhur me paragrafin 2 te LKA-së, lidhur me besueshmërinë e kërkesës për shtyerje te ekzekutimit.
4. Më datë, 20.02.2020, Gjykata e Apelit e Kosovës, duke vendosur sipas ankesave nga paragrafi 3, ka sjellë Aktvendimin **AA.nr.155/20**, me të cilin e ka anuluar Aktvendimin për Shtyerjen e Ekzekutimit të aktit të kontestuar nga paditësi dhe duke e kthyer çështjen

në **Rishqyrtim dhe Rivendosje**, për shkak se aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë ishte i përfshirë në shkelje nga neni 182 par.2 pika n) të LPK-së, pasi që gjykata nuk kishte paraqitur asnjë fakt dhe asnjë provë lidhur me faktet vendimtare, përkitazi me kërkesat ligjore që dalin nga dispozita e nenit 22 par.2 të LKA-së.

Në Rishqyrtim dhe Rivendosje, Gjykata e Apelit, e kishte obliguar gjykatën e shkallës së parë, që të marrë vendim të drejtë, i cili duhet të përmbaje me saktësi arsyetimin e dëmit që i shkaktohet paditësit, përkatësisht se me cilat prova e argumentohet dëmi që i shkaktohet paditësit, pastaj ta argumentoj se pse shtyerja nuk do të ishte në kundërshtim me Interesin Publik, si dhe ta vlerësoj e argumentoj se a mund t'i shkaktoj dëm personave të tretë – këtu palëve të interesit, shtyerja e ekzekutimit të aktit të kontestuar.

Vendimi i Gjykatës së Shkallës së Parë – A.nr.3090/19, i dt. 06.04.2020:

5. Në Rishqyrtim dhe në Rivendosje, Gjykata e shkallës së parë, më datë 06.04.2020, kishte marrë Aktvendimin **A.nr.3090/19**, me të cilin, përsëri e kishte aprovuar kërkesën e paditësit dhe kishte shtyer ekzekutimit e aktit të kontestuar.

Përsëri, as në Rivendosje, Gjykata e shkallës së parë nuk kishte dhënë sqarime se çfarë dëmi i shkaktohet paditësit dhe me cilat prova provohet i njëjti, as nuk kishte dhënë sqarime se pse shtyerja nuk është në kundërshtim me Interesin Publik, si dhe nuk kishte dhënë sqarime se si kishte ardhur në përfundim se palëve nuk do ti shkaktohej ndonjë dëm i madh, edhe pse të njëjtat i kishin prezentuar prova lidhur me investimet që kishin bërë deri tani dhe të cilat do të humbeshin nga shtyerja e ekzekutimit të aktit të kontestuar, **me çka gjykata e shkallës së parë nuk i ishte bindur obligimeve të caktuara nga Gjykata e Shkallës së dytë sipas Aktvendimit AA.nr.155/20.**

6. Kundër vendimit nga paragrafi 5, Palët e Interesit, kishin paraqitur ankesë, me pretendimin se i njëjti ishte i përfshirë në shkelje esenciale nga neni 182 par.2 pika n), pasi që nuk përmbante arsyetimin rreth plotësisht të kushteve ligjore të parapara me nenin 22 par.2 të LKA-së, përkatësisht se gjykata nuk kishte dhënë arsyetim se cili ishte dëmi që i shkaktohet paditësit me ekzekutimin e aktit të kontestuar, me çfarë prova provohet i njëjti, pse shtyerja e ekzekutimit të aktit të kontestuar nuk është në kundërshtim me Interesin publik dhe pse gjykata kishte vlerësuar se palëve të interesit nuk do ti shkaktohet ndonjë dëm i madh kur të njëjtat kishin paraqitur prova lidhur me investimet që deri më tani i kishin bërë, gati që afro 3 vjet që të vije deri tek nxjerrja dhe zbatimi i aktit të kontestuar.

Njëkohësisht, palët e interesit, ishin ankuar edhe për shkak të shkeljes së nenit 199 të LPK-së, nga gjykata e shkallës së parë, pasi që e njëjta nuk i kishte përfillur obligimet që i kishte përcaktuar gjykata e shkallës së dytë, lidhur me dhënien e sqarimeve dhe argumentimeve të fakteve vendimtare, të provuara me prova, sa i përket plotësisht të kushteve ligjore nga neni 22 par.2 i LKA-së.

Vendimi i Gjykatës së Shkallës së Dytë – AA.nr.355/2020:

7. Gjykata e Shkallës së Dytë, duke vendosur sipas ankesave të paraqitura, më datë 17.06.2020, ka marrë Aktvendimin **AA.nr.355/2020**, me të cilin ka refuzuar ankesat e paraqitura, duke **vërtetuar** Aktvendimin **A.nr.3090/2019**, të datës 06.04.2020, i marrë nga Gjykata Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Administrative.

Sipas gjykatës së shkallës së dytë, gjykata e shkallës së parë, kishte vendosur drejtë, pasi që janë plotësuar kushtet nga neni 22 par.2 të LKA-së, lidhur me shtyerjen e ekzekutimit të aktit të kontestuar, por as kjo duke mos dhënë detaje e as sqarime, përkritazi me çështjet e ngritura në ankesë, se gjykata e shkallës së parë nuk kishte dhënë sqarime se cili është dëmi i cili i shkaktohet paditësit, me çfarë prova dokumentohet i njëjti, pse shtyerja e ekzekutimit të aktit të kontestuar nuk është në kundërshtim me Interesin Publik dhe pse ka vlerësuar se palëve të treta nuk do ti shkaktohej dëm, **e tërë kjo siç vet e njëjta - gjykata e shkallës së dytë e kishte obliguar gjykatën e shkallës së parë**, për dhënien e këtyre sqarimeve.

II. SHKAQET E PARAQITJES SË KËRKESËS PËR RISHQYRTIM TË JASHTËZAKONSHËM TË VENDIMIT:

8. Si Gjykata e Shkallës së Parë, edhe Gjykata e shkallës së dytë, me vendimin e saj, ka shkelur nenin 175 lidhur me nenin 160 të LPK-së, për shkak se të njëjtat nuk kanë dhënë arsytetime rreth fakteve vendimtare të ngritura me ankesë nga palët e interesit, përkritazi me përfshirjen e aktvendimit të gjykatës së shkallës së parë në shkelje esenciale nga neni 182 par.2 pika n) të LPK-së, lidhur me mos dhënien e arsyeve rreth fakteve vendimtare për plotësimin e kërkesave ligjore që dalin nga neni 22 par.2 i LKA-së, për çka rezulton se edhe aktvendimi i gjykatës së shkallës së dytë është i përfshirë në shkelje esenciale nga neni 182 par.2 pika n) të LPK-së.

Gjykata e shkallës së parë dhe e dytë, ka shkelur dispozitat juridike të lartcekura, edhe me mos trajtimin e pretendimit të shfaqur nga palët e interesit se **paditësit i mungon legjitimiteti aktiv** për ta atakuar aktin e kontestuar në konflikt administrativ, dhe se padia e tij, me pretendimin që përmban e njëjta, është e parakohshme, për çka e njëjta duhet të hedhet poshtë, mbi dy baza, si e palejuar dhe si e parakohshme, siç parashihet në nenin 34 par.1, nenpar.1.1 dhe 1.3 të LKA-së.

9. Si Gjykata e Shkallës së Parë, edhe Gjykata e shkallës së dytë, kanë shkelur nenin 22 par.2 lidhur me par.6 të LKA-së, për shkak se nuk kanë qenë të përmbushur kushtet për shtyerjen e ekzekutimit të aktit të kontestuar – Vendimit V_1204_2019, të marrë nga ZRREE, më datë 27.11.2019, siç parashihet me dispozitën juridike në fjalë.

III. ARSYETIMI I SHKAQEVE PËR PARAQITJEN E KËRKESËS PËR RISHQYRTIM TË JASHTËZAKONSHËM TË VENDIMIT:

10. Aktvendimet e Gjykatës së shkallës së parë dhe të dytë, janë të përfshira në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, e paraparë në nenin 182 par.2 pika n) të LPK-së, për shkak se as njëri e as tjetri, nuk përmbajnë arsyet për faktet vendimtare

lidhur me shtyerjen e ekzekutimit të aktit të kontestuar të cilat kërkohen të ipen në përputhshmëri me kërkesat që dalin nga neni 22 par.2 i LKA-së, për shtyerjen e ekzekutimit të vendimit.

11. Me nenin 22 paragrafi 2 të LKA-së, parashihen kushtet që duhet përmbushur, në mënyrë që të shtyhet ekzekutimi i një vendimi me rastin e inicimit të konfliktit administrativ, përkatësisht: “Me kërkesën e paditësit, organi, akti i të cilit ekzekutohet, gjegjësisht organi që është kompetent për ekzekutim, mund ta shtyjë ekzekutimin deri në vendimin definitiv gjyqësor, nëse ekzekutimi do t'i sillte dëm paditësit, i cili vështirë do të riparohet, kurse shtyrja nuk është në kundërshtim me interesin publik, e as që shtyrja do t'i sillte ndonjë dëm të madh palës kundërshtare përkatësisht personit të interesuar.

Në përputhje me kërkesat e parapara nga dispozita juridike e lartcekur, fillimisht gjykata e shkallës së parë është dashur që në aktvendimin e saj, të paraqes faktet: se cili është dëmi që i shkaktohet paditësit nga ekzekutimi i aktit të kontestuar, pse nuk do të mund të riparohet ai dëm, se përse shtyrja nuk është në kundërshtim publik dhe për çfarë arsye gjykata ka vlerësuar se palëve të interesit të interesuara nuk do t'i shkaktoj asnjë dëm shtyrja e ekzekutimit të vendimit.

12. Gjykata e shkallës së parë, në aktvendimin e saj, në mënyrë të përgjithshme ka konstatuar se plotësohen kushtet nga neni 22 par.2 i LKA-së, por **nuk ka dhënë asnjë arsye konkrete** se cili është dëmi që i shkaktohet paditësit nga ekzekutimi i aktit të kontestuar, se dëmi i supozuar përse nuk mund të riparohet, nuk ka dhënë arsyetim se përse shtyrja nuk është në kundërshtim me Interesin Publik, e as nuk ka dhënë asnjë arsyetim se përse shtyrja nuk do ti sjellë ndonjë dëm palëve të interesit, për shkak se të njëjtat kanë shfaqur pretendimin se do ti shkaktohet dëm, dhe në mbështetje të pretendimeve të tyre gjykatës i kanë paraqitur prova lidhur me investimin 3 vjeçar që e kanë bërë për të ardhur deri tek akti i kontestuar.

Për dhënien e arsyeve lidhur me faktet vendimtare të lartcekura, gjykatën e shkallës së parë e kishte obliguar Gjykata e Shkallës së Dytë, kur çështjen e kishte kthyer në rishqyrtim dhe rivendosje, sipas Aktvendimit **AA.nr.155/202**, të dt.20.02.20.

13. Të gjitha çështjet e lartcekura, ishin adresuar në gjykatën e shkallës së dytë, por **edhe gjykata e shkallës së dytë, në vendimin e saj, nuk kishte dhënë asnjë arsyetim përkitazi me çështjet e ngritura nga palët ankuese** rreth faktit se gjykata e shkallës së parë nuk ka dhënë asnjë arsye sa i përket plotësimit të kushteve nga neni 22 par.2 të LKA-së, por e njëjta vetëm në mënyrë të përgjithësuar ka konstatuar se gjykata e shkallës së parë ka vendosur drejtë, duke mos dhënë arsyetim se si e ka vlerësuar se gjykata e shkallës së parë ka vendosur drejtë.

Me nenin 160, paragrafi 4 të LPK-së, parashihet se çfarë duhet përmbajtur arsyetimi i aktgjykimit, dhe atë “Arsyetimi i aktgjykimit përmban: kërkesat e palëve, faktet që i kanë parashtruar dhe provat që i kanë propozuar, cilat nga faktet e tilla i ka vërtetuar, pse dhe si i ka vërtetuar ato fakte, e po që se i ka vërtetuar me anë të provave, cilat prova i ka shfrytëzuar dhe si i ka vlerësuar ato.”, kurse me nenin 175 të LPK-së, parashihet se dispozitat juridike lidhur me

përmbajtjen e aktgjykimit, zbatohen përshtatshmërisht edhe për përmbajtjen e aktvendimeve, përkatësisht “Dispozitat e neneve 146, 153, 160 dhe 169 paragrafi 2 të këtij ligji në mënyrë të përshtatshme aplikohen edhe kur kem të bëjmë me aktvendimet.”

Andaj, në rastin konkret, si aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë, edhe aktvendimi i gjykatës së shkallës së dytë nuk janë përpiluar në pajtim me nenin 160 lidhur me nenin 175 të LPK-së, për shkak të mungesës së arsytimit lidhur me përmbushjen e kërkesave ligjore që rrjedhin nga nenin 22 par.2 i LKA-së, përkatësisht të fakteve vendimtare se cili është dëmi që i shkaktohet paditësit nga ekzekutimi i aktit të kontestuar, pse nuk mund të riparohet dëmi i supozuar, pse gjykata nuk kanë dhënë arsyetim sa i përket provave të cilat ia kemi bashkangjitur me të cilat palët e interesit i kanë argumentuar pretendimet e tyre lidhur dëmin që i shkaktonte shtyrja e ekzekutimit të aktit të kontestuar, se pse shtyrja e ekzekutimit të aktit të kontestuar nuk është në kundërshtim me Interesin Publik, pasi që i njëjti është nxjerrë me qëllime të realizimit të “Interesit Publik”.

14. Palët e interesit, kanë ngritur edhe çështjen e legjitimitetit të paditësit për të atakuar në konflikt administrativ aktin e kontestuar, pranë gjykatës së shkallës së parë dhe pranë gjykatës së shkallës së dytë, por asnjëra e as tjetra, nuk e kanë trajtuar të njëjtin, e as nuk kanë dhënë ndonjë sqarim lidhur me shfaqjen e pretendimeve tona se **paditësit i mungon legjitimiteti**, për çka në bazë të nenit 34 par.1, nenpar.1.3 të LKA-së, **padia e paditësit është dashur që të hudhet poshtë si e palejuar qysh në shqyrtimin paraprak të padisë.**

15. Palët e interesit, kanë ngritur edhe çështjen se pretendimi i paditësit, i paraqitur në padinë administrative të tij, **është i parakohshëm**, për shkak se paditësi ka paraqitur në padi pretendimin se të njëjtit, nga akti i kontestuar do t'i shtrenjtohet çmimi i energjisë elektrike, por akti i kontestuar nuk përmban asnjë përcaktim të shtrenjtimit të çmimit të energjisë elektrike, dhe në rast se akti i kontestuar në të ardhmen ndikon qoftë në ngritje apo zbritje të çmimit të energjisë elektrike, për këtë duhet nxirret Vendim i veçantë nga ZRREE, por pavarësisht pretendimit të shfaqur nga palët e interesit, i njëjti nuk është trajtuar as nga gjykata e shkallës së parë, e as gjykata e shkallës së dytë, duke mos u dhënë asnjë arsyetim rreth këtij pretendimi.

Andaj, bazuar në të lartcekura, rrjedh se pretendimi i paditësit, është i parakohshëm, pavarësisht se ka apo nuk ka të drejtë, për çka padia e të njëjtit, është dashur të hedhet poshtë në bazë të nenit 34 par.1, nenpar.1.1 të LKA-së.

16. Gjykata e shkallës së parë, ka shkelur nenin 22 par.2 lidhur me par.6 të LKA-së, kurse të njëjtat, nuk janë evituar as nga gjykata e shkallës së dytë, pasi që nuk ka ekzistuar asnjë prej kushteve që parashihen me këtë dispozitë juridike, që të shtyhet akti i kontestuar.

17. Akti i kontestuar, është akt përmes të cilit në të ardhmen, do arrihet të realizohen projekte për prodhimin e energjisë elektrike nga vet shteti i Kosovës, përmes energjisë diellore, duke shmangur blerjen e energjisë elektrike nga shtetet e rajonit (veçanërisht shtetit të Serbisë) dhe duke shmangur ndotjen e ajrit nga prodhimi i energjisë elektrike, me anë të qymyrit.

Sa i përket mos plotësimit të kushteve nga neni 22 par.2 lidhur me par.6 të LKA-së, për shtyerjen e ekzekutimit të aktit të kontestuar, theksojmë:

18. **Paditësit, nuk i shkaktohet asnjë dëm**, nga ekzekutimi i aktit të kontestuar, pasi i njëjti nuk sjellë asnjë detyrim që ndërlihet me paditësin, në mënyrë që të njëjtut të mund t'i shkaktohet ndonjë dëm i caktuar, e aq më pak i pariparueshëm, pasi që akti i kontestuar i referohet dhe sjellë obligime vetëm për palët e interesit dhe me të njëjtin nuk përcaktohet asnjë shtrenjtim i energjisë elektrike siç pretendon paditësi.

Lidhur me pretendimin e paditësit, sa i përket çmimit të energjisë elektrike, kjo gjë parashihet, me nenin 38 të Ligjit nr.05/L-084 për Rregullatorin e Energjisë, i cili parashihet se: *“Rregullatori miraton tarifën për shërbimet e rregulluara të energjisë bazuar në metodologjitë e tarifave për tarifën e rregulluara dhe në propozimet për rishikimin e tarifave të dorëzuara nga ndërmarrjet e energjisë. Vendimet e marra për këto propozime publikohen.”*, prej nga rrjedh se në rast se ka ndonjë vendim për shtrenjtim apo zbritje të çmimit të energjisë atëherë, paraprakisht duhet të merret Vendim nga Rregullatori, e i cili në rastin konkret nuk është marrur, andaj në mungesë të vendimit për shtrenjtim të energjisë elektrike, rezulton se pretendimi i paditësit është i paqëndrueshëm, i pabazuar në prova dhe se akti i kontestuar të njëjtut nuk i prek të drejtat e ligjshme apo interesin drejtëpërdrejtë të bazuar në ligj siç e kërkon LKA-së.

19. **Shtyrja e ekzekutimit të aktit të kontestuar cenon rëndë Interesin Publik**, pasi që akti i kontestuar ka rëndësi jetike për shtetin e Republikës së Kosovës dhe jetesën e qytetarëve të saj, dhe në rast se shtyhet ekzekutimi i aktit të kontestuar, rrezikohet jetesa e shëndoshë e qytetarëve të Republikës së Kosovës, cenohet Interesi Ekonomik i Republikës së Kosovës dhe cenohet subjektiviteti ndërkombëtar i Republikës së Kosovës.

Jetesa e qytetarëve të RKS-së, rrezikohet për arsye, se me aktin e kontestuar, pamundësohet ndotja e ambientit (veçanërisht ajrit), pasi që energjia elektrike, pjesërisht do të prodhohet nga panelet solare, dhe jo më tërësisht nga qymyri i cili ndot ajrin.

Interesi ekonomik, cenohet, për shkak se do të pamundësohet që Republika e Kosovës, të prodhojë vet energjinë elektrike, gjë që do të ndikonte në rritjen e zhvillimit ekonomik, dhe parandalonte që të importohet/blidhet nga vendet e rajonit energjia elektrike në shumica qindra miliona euro, e të cilat mjete nuk do t'i përfitojnë vendet e rajonit (veçanërisht shteti i Serbisë), por të njëjtat do të qarkullojnë brenda Republikës së Kosovës, duke kaluar në instancë të fundit në llogari të qytetarëve të Republikës së Kosovës.

Subjektiviteti ndërkombëtar, cenohet, për shkak se Republika e Kosovës është e anëtarësuar në “Traktatin e Komunitetit të Energjisë”, duke qenë e detyruar që të zbatoj kërkesat që dalin nga Traktati, dhe pikërisht **me qëllim të zbatimit të Traktatit, ZRRE ka nxjerre aktin e kontestuar**, dhe me shtyerjen e ekzekutimit të të njëjtut, rezulton se Republika e Kosovës nuk është duke i zbatuar detyrimet e përcaktuara me Traktatin në fjalë, përkatësisht është duke e shkelur të njëjtin, me çka tregon paaftësi për përmbushje të obligimeve ndërkombëtare. Paaftësia për përmbushjen e obligimeve ndërkombëtare,

në të ardhmen mund të rezultojë me pasoja të shumëfishta për Republikën e Kosovës, pasi e njëjta mund të humbas fondet e Bashkimit European, të cilat i arkëton për çdo vit në shuma prej miliona euro.

20. Dëmi që i shkaktohet palëve të treta – palëve të interesit, gjykata e shkallës së parë gabimisht ka konstatuar, kurse gjykata e shkallës së dytë ka rikonstatuar, se shtyrja e ekzekutimit të aktit të kontestuar, nuk i sjellë dëm palëve të treta, për shkak se palët e interesit, për të ardhur deri tek akti i kontestuar, kanë investuar që afro 5 vit shuma të majme montare dhe duke shpenzuar kohë në plotësimin e kushteve ligjore për pajisje me Autorizime Preliminare, për tu bërë pjesë e skemave mbështetëse të cilat përcaktohen nga akti i kontestuar.

Të gjithë investimin, palët e interesit, i kanë bërë bazuar në kërkesat që kanë dalur nga aktet juridike pozitive dhe kërkesat e ZRREE, me qëllim që të vije deri tek akti i kontestuar, përkatësisht zbatimi i aktit të kontestuar dhe në rast të shtyrjes së zbatimit të të njëjtit, atëherë i gjithë investimi i bërë për afro 5 vite, në vlera prej qindra mijëra eurosh për secilin prej palëve të Interesit, do të humbiste dhe tërë këto shuma të investuara, do të shëndrroheshin në dëm të shkaktuar për secilën nga palët e Interesit.

(Për sa i përket dëmit, specifikisht, i njëjti është elaboruar me prova në ankesën e paraqitur nga palët e interesit më datë 22.04.2020)

Investimi për periudhë afro 5 vjeçare, në shuma prej qindra mijëra euro, për secilin prej palëve të interesit, është fakt notor, se përbën shkaktim të dëmit të madh, për të njëjtat, për çka rezulton se gjykata e shkallës së parë dhe e dytë gabimisht kanë vlerësuar këtë fakt, madje duke i injoruar provat në tërësi, duke mos arsyetuar fare për shkaqet se për ç'arsye nuk i ka marrë për bazë pretendimet ankimore të palëve të interesuara, por vetëm duke konstatuar përmes frazës se paarsyetuar se kinse *“palëve të interesuara nuk ju shkaktohet dëm”*.

21. Bazuar në të lartcekurat, rezulton se gjykata e shkallës së parë dhe e dytë, gabimisht kanë konstatuar/rikonstatuar se janë plotësuar kumulativisht kushtet nga neni 22 par.2 të LKA-së, për shtyrjen e aktit të kontestuar, pasi që asnjëri prej kushteve të parapara me këtë dispozitë juridike nuk përmbushet, siç argumentohet më lartë.
22. **Duke e pasur parasysh faktin se dy vendimet e gjykatës se shkallës së parë janë esencialisht të njëjta, thuhet identike në mangësitë e tyre, është e paqarte se si Gjykata e Apelit herën e parë e anulon aktvendimin e paarsyetuar të shkallës së parë, kurse herën e dytë e vërteton aktvendimin me të njëjtat mangësi - të paarsyetuar. Një situatë e tillë, përbën kundërtënie në të njëjtin rast administrativo juridik, dhe e rrënon me themel parimin e sigurisë juridike dhe kërkesën që vendimet e gjykatave duhet të përmbajnë konsistencë në çështjet e njëjta apo të ngjashme të trajtuara nga ato, si dhe krijon konfuzion për sa i përket mënyrës së marrjes së vendimeve gjyqësore, gjë e cila mendojmë se duhet të adresohet në këtë rast nga ana e Gjykatës Supreme.**

IV. KËRKESA DREJTUAR GJYKATËS:

Andaj, mbështetur në të lartcekura, kërkojmë nga Gjykata Supreme e Kosovës, që e njëjta, në bazë të nenit 54, të bjen këtë:

A K T G J Y K I M

APROVOHET SI E BAZUAR Kërkesa për Rishqyrtim të Jashtëzakonshëm të Vendimit, e paraqitur nga Palët e Interesit:

NDRYSHOHET Vendimi i Formës së prerë - Aktvendimi AA.nr.355/2020, i marrë nga Gjykata e Apelit e Kosovës, më datë 17.06.2020, me të cilin është Vërtetuar, Aktvendimi A.nr.3090/19, i marrë nga Gjykata Themelore në Prishtinë, më datë 06.04.2020.


REFUZOHET Kërkesa e paditësit për shtyrjen e Vendimit V_1204/2019, i datës 27 nëntor 2019, i marrë nga Zyra e Rregullatorit për Energji Elektrike.

Apo në situatën më të pafavorshme,

A K T G J Y K I M

APROVOHET SI E BAZUAR Kërkesa për Rishqyrtim të Jashtëzakonshëm të Vendimit, e paraqitur nga Palët e Interesit:

ANULOHET Aktvendimi AA.nr.355/2020, i marrë nga Gjykata e Apelit e Kosovës, më datë 17.06.2020, dhe çështja i kthehet te njëjtës gjykatë në **RISHQYRTIM** dhe **RIVENDOSJE**.



Të Autorizuarit:

